VENDIM
Nr.579, datë 5.9.2007

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME "TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL", QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme "Tirana International School", që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha